



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - URED PREDSEDNIKA

UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2016
PËR KALKULIMIN E PAGËS SË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

Prishtinë, 28. 07.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

Sekretari i Zyrës së Presidentit,

Në mbështetje të Nenit 17 (2.7) dhe Nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009),
nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 01/2016
PËR KALKULIMIN E PAGËS SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i rregullave për kalkulimin e pagës së Presidentit të Republikës së Kosovës, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga zyrtaret dhe institucionet që merren me zhvillimin e sistemit të pagave në institucionet publike.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **“Presidenti”** nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **“Kryetari i Kuvendit”** nënkupton Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.3. **“Të ardhura e përgjithshme të Kryetarit të Kuvendit”** nënkupton pagën dhe pagesat shtesë mbi pagën bazë, që ka realizuar gjatë një muaji, Kryetari i Kuvendit, dhe që janë bërë përmes listës së pagave;

1.4. **“Divizioni i kalkulimit të pagave”** nënkupton njësinë përkatëse, në kuadër të Ministrisë së Financave apo në njësinë tjetër që vendos Qeveria, dhe i cili është përgjegjëse që të bëjë kalkulimin dhe administrimin e sistemit të pagave, shtesave në pagë dhe kompensimeve tjera për të gjithë të punësuarit që realizojnë pagën nga buxheti Republikës së Kosovës.

Neni 4

Niveli i pagës së Presidentit

1. Paga e Presidentit është paga më e lartë në kuadër të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Paga e Presidentit gjithmonë duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e lartë se të ardhurat e përgjithshme të Kryetarit të Kuvendit dhe udhëheqësve të tjerë institucional.

Neni 5

Kalkulimi i pagës së Presidentit

1. Divizioni i kalkulimit të pagave, kalkulon pagën e Presidentit, në baza mujore.
2. Kalkulimi i pagës së Presidentit, për muajin aktual, bëhet duke u bazuar në të ardhurat e përgjithshme mujore të Kryetarit të Kuvendit të muajit paraprak, duke i shtuar me së paku njëzet e pesë përqind (25%) të totalit të të ardhurave të përgjithshme të Kryetarit të Kuvendit.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit.

Fahri BREZNICA,
Sekretar i Zyrës së Presidentit

Prishtinë, 28. 07.2016